

3.4 HIDROIZOLUES ME THARJE TË SHPEJTË PËR RRJEDHJE UJI

HIDROSTOP



Njësia matëse	copë/kuti	Ngjyra/specifikime të tjera
3 kg	10 cp/kuti	Gri



HIDROSTOP

Hidroizolues me tharje të shpejtë për mbylljen e rrjedhieve.

PËRSHKRIMI

HIDROSTOP është hidroizolues me tharje të shpejtë pas kontaktit me ujin.

FUSHA E APLIKIMIT

HIDROSTOP përdoret për mbylljen e rrjedhjeve të ujit pasi zotëron tharje dhe ngjitje të shpejtë.

MËNYRA E PËRDORIMIT

1. Përgatitja e suportit

Suporti duhet të jetë i pastër, dhe i lagësht. Pjesët e mbetura, vajrat, bojrat duhet të pastrohen.

2. Aplikimi

Pjesës ku rrjedh uji duhet ti jepet formë konike në një thellësi 2 – 3 cm. HIDROSTOP duhet të shtohet gradualisht në ujë dhe të përzihet menjëherë deri sa të bëhet si një masë e lagësht. Masa e fituar preohet në vëndin e rrjedhies dhe mbahet aty për afro 2 minuta derisa të forcohet.

KONSUMI

Afërsisht 1,6 Kg HIDROSTOP nevojiten për përgatitjen e një volumi prej 1 L.

- Temperatura e aplikimit duhet të jetë ndërmjet +5°C dhe +35°C.
- Në rastet kur pjesa që do të mbushet ka volum të madh, HIDROSTOP mund të përzihet me një sasi rërë nga raporti 1:1 në volum deri në raportin 1:3 në volum. Në këtë mënyrë rritet edhe koha e punueshmërisë. Një mënyrë tjetër për rritjen e kohës së punueshmërisë është edhe shtimi i një sasive çimento të zakonshme.
- Gjatë aplikimit rekomandohet të përdoren doreza.



TË DHËNAT PËRFUNDIMTARE

Forma	Pluhur
Ngjyra	Gri
Sasia e ujit	30%
Densiteti i llaçit të thatë	1,05 ± 0,05 Kg/lit
Forca shtypëse	40,00 ± 2,00 N/mm ²
Forca në përkulje	7,00 ± 0,50 N/mm ²
Jetëgjatësia e produktit	2 - 3 min në +20°C

JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

12 muaj nga data prodhimit nëqoftëse ruhet në paketim original dhe të pahapur në vënde të mbrojtura nga dielli dhe ngrica

